

Platforma 125

Rrjeti i relacioneve për zhvillimin e qëndrueshëm mes Trentinos dhe Europës Ballkanike

Platforma 125 (P125) është një rrjet që përbashkon më shumë se 20 sipërmarrje private dhe subjekte no-profit, të kërkimit dhe institucionale, me aktivitet në Trentino (Provincë autonome dhe rajon italian i pozicionuar në Veri-Lindje të Italisë dhe në mes të harkut alpin) dhe të interesuar të punojnë me territorin e Ballkanit në projekte konkrete të zhvillimit të ambjentit. Kjo gjë në prespektivën për të mbështetur, nëpërmjet një bashkëpunimi ekonomik të frymëzuar në parime të etikës dhe të reciprocitetit si dhe nëpërmjet bashkëndarjes dhe transferimit të know-how, proceset e integritit European të nisur nga Shtetet e rajonit dhe duke favorizuar një rritje tërësore dhe respektive të objektivave të përbashkëta të Agenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

Objektivi primar i **P125** është bashkëpunimi me aktorët kryesorë të Vendeve Ballkanike në realizimin e projekteve të lidhura me sektoret e infrastrukturës dhe veprave publike, me inxhenjerinë e ndërtimit dhe të ambjentit si dhe në fushën e teknologjisë në mbështetje të agrikulturës duke vënë në dispozicion nëpërmjet një oferte unike dhe të integruar, -360 gradë-, njohuritë dhe përvojën zbatuese të arritura nga Trentino në më shumë se 40 vite autonomi territoriale që i kanë mundësuar atij sistemi rajonal të arrijë vendin e parë në Itali për cilësinë e jetës dhe të prodhimit të energjisë së pastër (klasifikimi nga Il Sole 24 ore dhe nga Italia Oggi).

P125 është pjesë e një kornize relacionesh tashmë 20-vjeçare që kanë parë Trentinon të ndërhyjë nëpërmjet disa OJQ-ve, akoma më përpara përfundimit të sulmeve luftarake, në mbështetje të popujve të lënduar nga pasojat e konfliktit në ish-Jugosllavi. Miqësia dhe projektet e partneritetit janë shtrirë në kohë edhe në aspektin institucional, edhe në shkëmbimin e hapave të mirë të ndërveprimit kulturor dhe social.

Në koherencë me procesin e rritjes dhe të zhvillimit që po përfshin Vendet e rajonit nga disa vite, tani është momenti i mundësisë së rritjes së miqësisë dhe bashkëpunimit duke forcuar projektet e kooperimit ekonomik dhe në fushën e inovacionit duke favorizuar kështu një udhëtim të përbashkët zhvillimi dhe rritjeje sistematike.

Mundësia e lidhur me **Platformën** është ajo që parashikon procese zhvillimi në grup duke përfshirë bashkë me sipërmarrje trentine dhe ballkanike të gjithë faktorët e tjerë për një zhvillim ekueo dhe të qëndrueshëm: qeveritë lokale dhe qendrore, ambasadat, organizatat ndërkombëtare dhe subjektet e llojit si shoqëri ashtu edhe ekonomike.

Zhvillimi i relacioneve të kooperimit edhe ekonomik lind nga përafrimi i këtyre relacioneve me ligjin e ri kombëtar italian për kooperimin për zhvillim 125/2014 (nga ku **Platforma** merr emrin) dhe në linjat guida të sektorit të Provincës autonome të Trentos. Në këtë mënyrë korniza kombëtare dhe territoriale njeh rolin qendror që relacionet ekonomike dhe sektori fitimprurës mund të marrin përsipër për një kooperim për zhvillimin realisht efikas.

Forca e **Platformës** bazohet në shumëllojshmërinë e kompetencave që përmban në brendësi të saj. Janë përfshirë në **P125** një grup sipërmarrjesh të njohura në nivel territorial dhe kombëtar, me një bilanc kompleksiv që kalon shumën 105.000.000,00 euro dhe ca. 600 punonjës.

Bashkëpunojnë me **Platformën** Entet kryesore të kërkimit në Trentino, duke u nisur nga Universiteti i Studimeve të Trentos dhe në veçanti Departamenti i inxhenjerisë që promovon aktivitetin e kërkimit dhe të formimit, me vëmendje të veçantë ndaj cilësisë së ambjentit natyror dhe urban, ndaj përmirësimit të cilësisë së jetës, ndaj sigurisë dhe zhvillimit harmonik të shoqërisë nëpërmjet rinovimit të prodhimeve. Një tjetër Ent i rëndësishëm i përfshirë në **Platformë** është Fondacioni Bruno Kessler: fondacion kërkimi i njohur në mënyrë të veçantë në planin ndërkombëtar për aktivitetet e saj të lidhura me ICT, në teknologjitë për materialet dhe ndaj zgjuarsisë artificiale.

Në fund, **Platforma** ka mbështetjen e enteve lokale duke u nisur nga Këshilli Qeveritar i Provincës Autonome të Trentos, që garantojnë një kornizë institucionale dhe lëvizjen e sistemit të **Platformës**. Në planin operativ, subjektet e ndërhyrjes primare në **Platformë** janë Shërbimi i ndërkombëtarizimit i Provincës Autonome të Trentos, ADEP – Agjencia e përpunimit të ujërave e Provincës Autonome e Trentos dhe Trentino Sviluppo - Zhvillimi Trentin. Këto ente, përveçse garantojnë mbështetjen e nevojshme institucionale dhe me përfaqësuesit e qeverisë, vënë në dispozicion kompetenca specifike respektivisht në sektorët e relacioneve ndërkombëtare, të përpunimit të ujërave dhe të menaxhimit të mbetjeve si dhe të relacioneve ekonomike të huaja. Pjesë e rrjetit të **Platformës** janë edhe Con.Solida, Urdhri i Inxhenjerëve të Provincës së Trentos, Dhoma e Tregtisë Industrisë dhe Artizanatit, Confesercenti dhe Konfederata e tregtisë, Euricse dhe Instituti i Formimit Profesional të Hotelierisë të Levico Terme dhe Rovereto.

Çfarë ofron Platforma: kompetenca, specializime, shërbime

Platforma 125 është e përbërë nga një grup shoqëri inxhenjerash, arkitektësh dhe administratorësh që mbulojnë 360° nevojat e klientëve dhe nga një grup sipërmarrjesh me kompetenca të larta të specializuara në sektorët e ambjentit, energjisë së rinovuar dhe në veprat civile dhe në infrastrukturat publike.

Kabina e regjisë

P125 koordinohet nga një kabinë regjie që mbulon menaxhimin dhe kujdesin e rrjetit dhe të relacioneve me entet institucionale dhe të kërkimit trentine dhe ballkanike. Kabina e regjisë është e përbërë nga dy organizata kooperimi ndërkombëtar dhe nga disa sipërmarrje anëtare të **Platformës**: Dy organizatat no-profit janë:

- **ASSOCIAZIONE TRENINO CON I BALCANI** – ideatorja e **Platformës**. Shoqata no-profit e kooperimit të decentralizuar të komunitetit e cila që nga fillimi i viteve '90 koordinon relacionet mes Trentinos dhe Ballkanit me mandatin e Provincës Autonome të Trentos;
- **FONDAZIONE PUNTO.SUD** – Organizatë pa qëllim fitimi e pavarur që vepron nga vitit 1999 në kooperimin ndërkombëtar dhe në sektorin social për të përpunuar, eksperimentuar dhe shpërndarë zgjidhje efikase për të përmbushur nevojat sociale lokale dhe globale, në Itali dhe në botë.

Associazione Trentino con i Balcani koordinon kabinën e regjisë.

ENGINEERING, CONSULTANCY and MANAGEMENT

Sipërmarrjet e konsulencës dhe të menaxhimit, anëtare të **P125**, lidhin njohjet e zhvilluara me aktivitetin e eksperimentimit dhe të kërkimit me synimin për të harmonizuar efikasitetin maksimale funksionale të veprës me transformimin e konteksteve. Shoqërojnë zgjidhje teknike me një sekuençë të artikuluar vlerësimesh formale, ekonomike dhe ambientale. Është një grup sipërmarrjesh të specializuara në sektorin e inxhenjerisë civile dhe ambientale, në konsulencën ambientale dhe akustike. Në veçanti promovojnë vepra:

- rehabilitimi i zonave të kontaminuara;
- menaxhimi dhe ndarja e mbetjeve të forta dhe të lëngëta;
- impjante përpunimi ujërash civile dhe industriale;
- impjante të llojit të përgjithshëm dhe elektrik;
- impjante të sektorit të prodhimit ekonomik, të rrjeteve dhe të burimeve të rinovueshme;
- infrastruktura rrjetesh (ujësjellësa, kanalizime, shpërndarje të gazit, impjante ujitjesh, rrjete elektrike dhe telengrohëse);
- kategorizimi ambiental, i tokave dhe guroreve për gërmim dhe përkufizimi i modaliteteve të menaxhimit; kampione ambientale (tokë, uji, sipërfaqe, ujëra të nëndheshëm, mbetje ...);
- projektimi dhe ekzekutimi i planeve të ndarjes, përpunimit të analizave të zonave me rrezik sanitar-ambiental të veçanta dhe në projektimin e ndërhyrjeve të rehabilitimit (tokë, gropa përpunimi mbetjesh dhe ujërash të ndotur);
- ndërtime turistike dhe restaurime mbrojtëse të pasurive të paluajtshme (drejtimi i punimeve, kontabiliteti i kantierit, interior Design, llogaritë preventivuese, përpunime pajisjesh).

Sipërmarrje të sektorit që janë anëtarësuar në Platformën 125:

- TING GROUP
- TERA GROUP SRL
- ING. VITO BERTÈ
- ISER SRL
- ARCH. ROLANDO BONAZZA
- CM INGEGNERI DI CRISTOFOLINI ING. MARCO

Faturimi kompleksiv:

2.700.000,00 €

Numri kompleksiv i punonjësve:

57

ENVIRONMENT

Një administrim ambiental i kujdesëshëm dhe i qëndrueshëm është forca e **P125** si dhe akoma më shumë e sipërmarrjeve që veprojnë në territorin Trentin, që bën me trashëgiminë natyrore një trampolin të zhvillimit turistik dhe ekonomik lokal.

Sipërmarrjet e përfshira në **P125** garantojnë shërbime të profilit të lartë, duke ju drejtuar enteve institucionale dhe private në sektoret e kompetencave respektive, me një staf administrimi specialistësh të lartë, të aftë të propozojnë zgjidhjet më të mira tekniko-ekonomike në favor të klientelës, me vëmendje të veçantë ndaj detyrave të menaxhimit dhe impaktit ambiental. Në mënyrë të veçantë promovojnë vepra:

- kërkimi, projektimi dhe sistemimi në fushën ambientale, administrimin e të dhënave gjeografike dhe planifikimin territorial;
- kërkimi dhe zhvillimi i prodhimeve software (App) dhe zgjidhjeve web-GIS për sektorin pyjor dhe ambiental;

- vepra publike në fushën e ujitjes dhe të kanaleve hidraulike në shkallë të mesme e të lartë;
- impjante elektrike civile industriale, impjante energjie alternative;
- impjante termosanitare, ujësjellësash, ajri të kondicionuar, ngrohjeje;
- vepra rrugore, ujërash të ndotura, urbanizime, bonifikime agrare;
- infrastrukturë rrugësh, urbanizim, asfaltim;
- shërbime higjienë ambientale, mbledhje dhe administrim mbetjesh me cilësi të lartë;
- impjante trajtimi ujërash primare dhe të ndotura (impjante përpunimi ujërash, trajtim të finalizuar ujërash të ndotura në ujëra të pijshëm - bonifikim);
- rekuperim mbetjesh të metalit, automobilash, dhe të gjitha tipologjitë e mbetjeve, të rrezikshme apo jo, prodhime nga aktivitete të ndryshme, artizanale, industriale dhe të sektorit të prodhimit ekonomik, me një vëmendje të veçantë ndaj ruajtjes së ambientit;
- projektimi dhe ndërtimi i sistemit elektrik të fuqishëm, komandim dhe kontrolli në sektorë të ndryshëm.

Sipërmarrje të sektorit që janë anëtarësuar në Platformën 125:

- EFFETRESEIZERO SRL
- SOGAP SRL
- TRENINO ACQUE S.R.L.
- IDROTECH
- RIGOTTI F.LLI SRL
- SG ELETTRICA
- ALBATROS SRL
- SICOS (Kompani pjesë të rrjetit: - Tecnoelettronica; - Ndërtime Hidroelektrike Battan Ivan; - Girardi termosantari; - Edilpavimentazioni)

Faturimi kompleksiv:

16.875.000,00 €

Numri kompleksiv i punonjësve:

118

CIVIL CONSTRUCTION

Sektori i ndërtimeve civile përfaqësohet nga një grup sipërmarrjesh që përmban një rrjet ekspertësh në sektorin e ndërtimeve dhe të infrastrukturës, që ofrojnë vëmendje të veçantë ndaj qëndrueshmërisë dhe energjetikës efçente. Në mënyrë të veçantë këto sipërmarrje promovojnë vepra:

- realizimi i infrastrukturave të ndryshme;
- realizimi i strukturave të mëdha për përdorim publik (shkolla, spitale, teatro, shtëpi pushimi, etj.);
- realizimi i komplekseve rezidenciale dhe turistike.

Sipërmarrje të sektorit që janë anëtarësuar në Platformën 125:

- **TCI TRENINO CONSTRUCTION INTERNATIONAL** (Kompani pjesë të rrjetit: - Consorzio Stabile Trentino; - Misconel; - X Lam Dolomiti & Group; - Idrotech; - Martinelli & Benoni; - Costruzioni Carraro Geom. Adriano; - Pedrotti Impianti; - Georocce; - Impresa Costruzioni Basso Sarca; - GIPS - Consorzio Costruttori a Secco; - MAK Costruzioni)

Faturimi kompleksiv:

85.000.000,00 €

Numri kompleksiv i punonjësve:

415

GREEN ENERGY

Një fushë e rëndësishme zhvillimi e sipërmarrjeve trentine që bëjnë pjesë në **P125** është ajo e prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme dhe në veçanti nga burime ujore, për të cilat rajoni është i pasur. Nuk mungojnë specializimet në përdorimin e burimeve të tjera të energjisë së rinovueshme. Sipërmarrjet e përfshira në **P125** për këtë sektor, zbatojnë teknologji inovative dhe të konsoliduara mbi eksperiencën e maturuar, duke kërkuar zgjidhje teknike dhe ekonomikisht pozitive, për çdo impjant të veçantë, për të garantuar prodhimin maksimal të energjisë në mënyrë kompakte me disponimin e burimeve ujore dhe në respekt me ambientin përreth. Në mënyrë të veçantë promovon vepra:

- konsulencë energjetike, monitorim impjantesh;
- burime fotovoltaike dhe të tjera të rinovueshme (impjante eolike, impjante hidroelektrike, biomasa);
- ndërhyrje energjetike efikente (kogjeneracion/trigjeneracion, rekuperim termik, sisteme ndriçimi me konsum të ulët, etj.), rrjete inteligjente;
- impjante hidroelektrike me ujësjellësa të pijshëm: projektim, ndërtim dhe instalim impjantesh me ujësjellësa të pijshëm dhe ujitës.

Sipërmarrje të sektorit që janë anëtarësuar në Platformën 125: <ul style="list-style-type: none">- ELETTO ALDRIGHETTI- SINGEA SRL- PELLEGRINI CARLO- TAMANINI HYDRO- OMTON	Faturimi kompleksiv:
	2.700.000,00 €
	Numri kompleksiv i punonjësve:
	15

RISK MANAGEMENT

Në përballjen e botës së tenderave është me rëndësi themelore suporti i profesionistëve të aftë të furnizojnë analiza mbi rrezikun e sipërmarrjeve dhe për të gjetur instrumentët e përshtatshëm të mbulimit sigurativ dhe financiar. Shërbimet që ofrohen janë:

- Due Diligence assicurativa;
- risks Analysis;
- claim Analysis;
- incident Reporting;
- contract Analysis.

Sipërmarrje të sektorit që janë anëtarësuar në Platformën 125:

- MEC.VIS RISK AND INSURANCE ADVISOR